



# PËRMBAJTJA

## MISIONI

MISIONI I KDI ËSHTË TË MBËSHTESË ZHVILLIMIN E DEMOKRACISË DUKE FUNDIZUAR QYTETARËT DHE SEKTORIN JOQEVERITAR PËR TË NDIKUAR NË RRRITJEN E TRANSPARENCËS, PËRGJEGJSHMËRISË DHE LLOGARIDHËNIES SË INSTITUCIONEVE QEVERITARE DHE PËRMIRËSIMIT TË EFIKASITETIT TË KËTYRE INSTITUCIONEVE PËRMES PJESËMARRJES SË QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE.

## VIZIONI

KDI SYNON TË JETË NJË ORGANIZATË RAJONALE ME NDIKIM NË PROCESET POLITIKE PËRMES OFRIMIT TË ASISTENCËS NË PROCESIN E DEMOKRATIZIMIT.

## MISSION

KDI'S MISSION IS TO SUPPORT DEMOCRATIC DEVELOPMENT BY EMPOWERING NONGOVERNMENTAL ORGANIZATIONS AND CITIZENS TO ENHANCE THE TRANSPARENCY, ACCOUNTABILITY AND RESPONSIVENESS OF GOVERNING INSTITUTIONS AND IMPROVE THE EFFICIENCY OF THESE INSTITUTIONS THROUGH CITIZEN PARTICIPATION IN DECISION-MAKING.

## VISION

KDI AIMS TO BE REGIONAL ORGANIZATION THAT INFLUENCES POLITICAL PROCESSES BY OFFERING ASSISTANCE IN THE PROCESS OF DEMOCRATIZATION

3. Hyrje
4. Funksionimi i Kuvendit
4. Numri i projektligjeve, rezolutave, deklaratave, vendimeve dhe përfundimeve
5. Ligjet e pushpallura nga PSSP-ja
6. Seancat plenare të mbajtura dhe trajtimi çështjeve
7. Kërkesat në interpelancë
7. Pyetjet parlamentare
8. Komisionet funksionale dhe kryesore

## TABLE OF CONTENTS

- |    |  |
|----|--|
| 11 | INTRODUCTION   |
| 12 | Role of the Assembly   |
| 12 | Number of draft-laws, resolutions, declarations, decisions and conclusions |
| 13 | Un-promulgated laws by the SRSG are:                                       |
| 14 | Plenary sessions and discussed issues                                      |
| 15 | Requests on interpellation   |
| 16 | Parliamentary questions  |
| 17 | Main and functional Committees   |
| 19 | Our Staff  |



# HYRJE





# Publikimet tona

Instituti Demokratik i Kosovës KDI që nga shkurti i vitit 2006 është duke bërë monitorimin proaktiv të punës së kuvendit të Kosovës dhe disa kuvendeve komunale.

Në monitorimin e punës së Kuvendit të Kosovës për periudhën tre-vjeçare, nëpërmes këtij raporti KDI provon të kontribuoj në ofrimin e informacioneve të strukturuar të cilat do të jenë në shfrytëzim, para së gjithash për qytetarin e Kosovës, shoqërinë civile, mediat, si dhe vetë institucionin e monitoruar, Kuvendin e Kosovës. Në këtë drejtim, në formë të renditur nëpërmes këtij raporti ofrojmë të dhëna të cilat pasqyrojnë disa aspekte të punës së Kuvendit. KDI nëpërmjet monitorimit proaktiv dhe por edhe në bashkëpunim me institucionin e Kuvendit si dhe palë të përfshira në këtë proces, KDI ka arritur t'i siguroj këto informacione, të cilat do të mund të zhvilloheshin edhe më tej, në rast të një bashkëpunimi më cilësor nga ana e institucioneve, apo edhe në rast të organizimit dhe funksionimit të tyre më të mirëfilltë. Nëpërmes aktiviteteve monitoruese KDI është përfshirë në këto drejtime si puna në seanca plenare, puna në komisione parlamentare, interpelanca dhe procesi i ligje-bërjes. Gjatë mandatit tre vjeçar 2004-2007 Kuvendi i Kosovës ka proceduar me projektligje, ligje, amandamente, rezoluta, deklarata, vendime dhe përfundime.

KDI me këtë rast i falenderon të gjithë partnerët, zyrtarët e zgjedhur dhe stafin e kuvendit, për kontributin e dhënë në materialet e të cilat mundësuan përpilimin e këtij raporti tre vjeçar.

**Ismet Kryeziu**  
Drejtor ekzekutiv



# I. Raport mbi Punën e Kuvendit të Kosovës për mandatin 2004-2007

## FUNKSIONIMI I KUVENDIT

Kuvendi i Kosovës zhvillon punimet përmes seancave plenare dhe komisioneve parlamentare. Kuvendi i Kosovës ndërmer veprime nëpërmes trupave përkatës, siç janë, Kryesia e Kuvendit, Grupet Parlamentare, Komisionet Parlamentare, dhe Deputetet Individual. Mbi bazën e "Dispozitave Të Përgjithshme" e cila përcakton organizimin dhe funksionimin e Kuvendit të Kosovës në përgjithësi, si dhe të gjithë trupave më të vegantë të cilët i themelon Kuvendi në bazë të "Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës", rezultat i këtij organizimi dhe funksionimi i Kuvendit mund të përkufizohet kryesisht, në nxjerrjen e:

- Amendamenteve
- Deklaratave
- Projektligjeve
- Ligjeve
- Mocioneve
- Rezolutave



Për nga natyra, këto dokumente ndahen në dokumente me forcë ligjore detyruese për Kuvendin dhe palët e treta, si dhe në dokumente jo detyruese. Vlen të theksohet se misioni më i rëndësishëm dhe më parësor për secilin institucion përfaqësues është nxjerrja e ligjeve nëpërmes të cilave rregullohet krijimi, mbarëvajtja dhe funksionimi i institucioneve tjera, si dhe rregullimi i fushave të caktuara shoqërore me të cilat ndërlidhen me institucionet. Kuvendi i Kosovës gjithashtu, ka për qëllim nxjerrjen e ligjeve demokratike si dhe ngritjen e mirëqenies së qytetarëve të Kosovës të cilët i përfaqëson brenda mandatit aktualisht tre-vjeçar.

Në parim, mbi bazën e dokumenteve të lartpërmendur Kuvendi i qaset një pune e cila përmbledh një nismë për deklarate, projektligj, rezolute apo dokument tjetër. Si hap i dytë, Kuvendi nëpërmes seancave plenare, si dhe ato të komisioneve shqyrton dhe ri-shqyrton më tutje dhe më hollësisht një nismë të dhënë. Përfundimisht, Kuvendi vendos për formën përfundimtare të një nisme duke e zyrtarizuar edhe ligjërisht atë, në rast të kundërt e hedh poshtë.

## NUMRI I PROJEKTLIGJEVE, REZOLUTAVE, DEKLARATAVE, VENDIMEVE DHE PËRFUNDIMEVE


Qeveria e Kosovës gjatë legjislaturës 2004-2007, i ka proceduar pranë Kuvendit të Kosovës 151 projektligje, ndërsa Kuvendi me nismë vetanake ka proceduar edhe me 6 të tjera nga numri i total prej 157 projektligjesh. Si rezultat i tyre, Kuvendi ka nxjerrë dhe miratuar gjithsej 95 ligje. Prej këtyre projektligjeve 31 gjenden në procedurën e shqyrtimeve ndërsa 31 të tjera i janë kthyer Qeverisë për ri-draftim të serishëm.

Kuvendi i Kosovës gjatë këtij mandati ka iniciuara gjashtë nisma legjislative -(projektligje):

- Projektligji për shpronësim
- P/ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.2003/7 për Lenden arkivore dhe arkivat
- P/ligji për procedurën e dhënies së koncesioneve
- P/ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.2003/7 për Lenden arkivore dhe arkiva
- P/ligji për te drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit P/ligji për hetim parlamentar
- Kurse deputeti Fehmi Vula ka paraqitur nismën për P/ligjin për Kryqin e Kuq të Kosovës

# I. Raport mbi Punën e Kuvendit të Kosovës për mandatin 2004-2007


Në bazë të Kornizës Kushtetuese të Kosovës, ligjet të cilat kalojnë si të miratuara nga Kuvendi procedohen për shpallje, pezullim, apo refuzim nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, PSSP-së. Kësisoj, PSSP-ja nga volumi i ligjeve që i janë dërguar nga Kuvendi, ka shpallur 74 ligje, ndërsa 32 mbeten të pa-shpallura.



**Mos hartimi i projektligjeve në përputhje me normat dhe standardet e kërkuara, duke mos përjashtuar edhe implikimet buxhetore kanë bërë që 31 projektligje t'i kthehen në ripunim Qeverisë së Kosovës.**

Në seancat plenare, në Kuvendin e Kosovës gjatë mandatit 2004-2007 janë miratuar 5 Rezoluta, 3 Deklarata, 88 Vendime dhe 16 Përfundime. Ndër rezolutat dhe Deklaratat e miratuara në Kuvendin e Kosovës janë: Rezoluta kundër krimit në fushën e kibernetikës, Rezoluta për ri-konformimin e vullnetit politik të popullit të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran, Deklarata e Kuvendit të Kosovës për shpërthimet në Kosovë 21 Shtator 2006, Deklarata e Kuvendit të Kosovës për Kushtetutën Serbe, Deklaratë e Kuvendit të Kosovës për miratimin e Rezolutës së Parlamentit Evropian.

**Numri i Rezolutave, Deklaratave, Vendimeve dhe Përfundimeve**



## LIGJET E PA-SHPALLURA NGA PSSP-JA PËRMBLIDHEN NË:

- Ligji për lirinë e asociimit në QJQ
- Ligji për sigurinë e përgjithshme të produkteve
- Ligji për ngrohjen qendrore
- Ligji për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civil të luftës.
- Ligji për konfliktet administrative
- Ligji për ndërprerjen e shtatëzënsisë
- Ligji për hulumtime gjeologjike
- Ligji për sigurinë në komunikacionin rrugor
- Ligji për sigurimet shëndetësore
- Ligji për shëndetësinë publike
- Ligji për mbrojtjen nga zhurma
- Ligji për bletarinë
- Ligji për transfuzionin e gjakut, kontrollin e gjakut dhe produkteve të tij
- Ligji për numrin personal
- Ligji për emrin personal
- Ligji për kimikate
- Ligji për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse
- Ligji për plotësim dhe ndryshim të Ligjit 2003/4 për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridik.
- Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit 2003/14 për planifikim hapësinor
- Ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje
- Ligji për letërnjoftimin
- Ligji për ndryshim dhe plotësim të ligjit 2004/1 për transportin rrugor
- Ligji për bujqësinë organike
- Ligji për ndryshim dhe plotësim të ligjit 2004/46 për regjistrat e gjendjes civile
- Ligji për gjendjen civile
- Ligji për shoqëritë tregtare
- Ligji për vendbanim dhe vendqëndrim
- Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit 2003/25 për kadastër
- Ligji për arbitrazhin
- Ligji për mbrojtjen e varieteteve të bimëve
- Ligji për raportin financiar të ndërmarrjeve
- Ligji për shpronësim

# I. Raport mbi Punën e Kuvendit të Kosovës për mandatin 2004-2007



**PJESA MË E MADHE E DEBATEVE QË JANË PARASHTRUARA DHE DISKUTUAR NË SEANCA PLENARE, NË KUVENDIN E KOSOVËS KANË QENË TË NATYRËS POLITIKE, TË CILAT I KA KARAKTERIZUAR KRYESISHT PROCESI I RRJEDHJES SË BISEDIMEVE RRETH STATUSIT TË KOSOVËS DHE MUNDËSISË SË ZGJIDHJES SË TIJ, DUKE PASUAR ME DEBATET QË I PËRKASIN SFERËS SOCIALE, EKONOMIKE DHE ASAJ TË SIGURISË.**




## SEANCAT PLENARE TE MBAJTURA DHE TRAJTIMI ÇËSHTJEVE

Gjatë mandatit 2004-2007, Kuvendi i Kosovës ka mbajtur gjithsej 63 seanca plenare dhe mbi 700 mbledhje të komisioneve parlamentare. Në këto seanca plenare ndër çështjet e rëndësishme dhe me interes publik që janë diskutuar janë:

- Debati për Qendrën Administrativo- Protokollare- QAP "Gërmia",
- Debati për gjendjen e rënde në Universitetin e Prishtinës,
- Debati për gjendjen energjetike në Kosovë,
- Debati për gjendjen e sigurisë,
- Debati për gjendjen e pensionisteve,
- Debati për gjendjen e rënde në shëndetësi,
- Debati për çështjen e personave të pagjetur,
- Debati për Arsimin dhe Rininë
- Debati rreth "Pakos së Ahtisaar-it", si dhe debatet e gjera rreth rrjedhës së bisedimeve për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës në Vjenë.

Gjatë vitit 2005 Kuvendi ka mbajtur 11 seanca plenare, në vitin 2006 ka shënuar numrin më të madh të mbajtjes së seancave plenare, gjithsej 27, kurse viti 2007 është karakterizuar me mbajtjen e 25 seancave plenare. Poashtu, Kuvendi ka thirrur 16 interpelanca lidhur me logaridhënien e ekzekutivit.



Numri i seancave plenare gjatë viteve



# I. Raport mbi Punën e Kuvendit të Kosovës për mandatin 2004-2007

## KËRKESAT NË INTERPELANCË

Grupet Parlamentare kanë inicuar procedura të Interpelancës, procedurë kjo parlamentare e cila kërkon nga qeveria të shpjegojë veprimin apo mosveprimin në lidhje me një çështje të caktuar, ligjore apo politike. Kështu, Kuvendi i Kosovës, respektivisht grupet parlamentare kanë ushtruar këtë procedure duke thirrur 16 interpelanca apo kërkesë llogaridhënie nga ekzekutivi siç vijon:

### Në vitin 2005 janë thirrur 5 interpelanca:


- Interpelancë e Kryeministrit Ramush Haradinaj me kërkesë të G/P të PDK-së
- Interpelancë e Ministrit Slavisha Petkoviq me kërkesë të G/P- SLKM
- Interpelancë e Kryeministrit Bajram Kosumi me kërkesë të G/P të PDK-së
- Interpelancë e Kryeministrit Bajram Kosumi me kërkesë të G/P të PDK-së
- Interpelancë e Ministres Melihate Termkolli me kërkesë të G/P të PDK-së

### Në vitin 2006 janë thirrur 5 interpelanca:

- Interpelancë me Ministres Melihate Termkolli me kërkesë të G/P të PDK-së
- Interpelancë me Ministrit Qemajl Ahmeti me kërkesë të G/P të PDK-së
- Interpelancë me Ministrit Adrian Gjini me kërkesë të deputetit Naser Osmani të përkrahur edhe nga 10 deputete nga radhët e G/P të LDK-së
- Interpelancë me Kryeministrit Agim Çeku me kërkesë të G/P të PDK-së
- Interpelancë me Ministrit Sadik Idriz me kërkesë të G/P ORA

### Në vitin 2007 janë thirrur 6 interpelanca:


- Interpelancë me Ministrit Haki Shatri me kërkesë të G/P – ORA
- Interpelancë me Kryeministrit Agim Çeku me kërkesë të G/P- ORA
- Interpelancë me Kryeministrit Agim Çeku me kërkesë të G/P- ORA
- Interpelancë me Ministrit Ethem Çeku me kërkesë të G/P të PDK-së
- Interpelancë me Ministrit Agim Veliu me kërkesë të G/P – ORA
- Interpelancë me Ministrit Agim Veliu me kërkesë të G/P- Integrim



Kërkesat në Interpelancë gjatë viteve

## PYETJET PARLAMENTARE

Nëpërmes pyetjeve parlamentare, çdo anëtar i Kuvendit mund t'i kërkojë një anëtar të qeverisë llogaridhënie apo shpjegim në lidhje me ndonjë çështje të caktuar. Gjatë periudhës në fjalë, viti 2004-2007 në Kuvendin e Kosovës, në seanca plenare janë parashtruar 196 pyetje parlamentare. Pjesa më e madhe e pyetjeve të parashtruara me shkrim nga deputetët e Kuvendit kanë marrë përgjigje nga ministrat përkatës të cilëve iu është adresuar pyetja, derisa 14 pyetje që nuk kanë marrë përgjigje janë publikuar në "Buletinin Informativ" të Kuvendit të Kosovës.



Numri i Pyetjeve Parlamentare

# I. Raport mbi Punën e Kuvendit të Kosovës për mandatin 2004-2007

## KOMISIONET FUNKSIONALE DHE KRYESORE

Komisionet Parlamentare paraqesin shtyllat themelore mbi të cilat bazohet volumi më i madh i aktiviteteve të Kuvendit, ndarja e tyre konsiston në komisione funksionale dhe kryesore. Kuvendi i Kosovës mund të krijoj edhe komisione tjera sipas nevojës, komisionet me pajtim të kryesisë së Kuvendit mund të themelojnë edhe nën-komisione përkrahëse.

Gjatë mandatit për të cilin raportohet, Kuvendi ka numëruar gjithsej 10 komisione parlamentare prej të cilave 8 janë funksionale kurse 2 janë kryesore: Komisioni për Buxhet dhe Financa, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Komisioni për Arsim, Rini, Shkencë, Kulture dhe Teknologji, Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Komisioni për Bashkëpunim dhe Integritet Euroatlantike, Komisioni për Siguri, Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport, Miniera dhe Minerale, Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media si dhe Komisioni ad-hoc i krijuar për Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës. Komisionet e Kuvendit të Kosovës gjatë mandatit 2004-2007 kanë mbajtur mbi 700 mbledhje.

- Komisioni për Buxhet dhe Financa gjatë mandatit 2004-2007 ka mbajtur 156 mbledhje, ka shqyrtuar 148 projektligje, ka organizuar 5 dëgjime publike dhe 7 dëgjime buxhetore
- Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka mbajtur gjithsej 102 mbledhje dhe ka shqyrtuar 148 projektligje
- Komisioni për Legjislacion, Kornizë Kushtetuese, Barazi Gjinore, Peticione ka mbajtur 80 mbledhje, katër dëgjime publike dhe ka hartuar tri nisma legjislative: P/ligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, P/ligjit për hetim parlamentar dhe P/ligji për avokatin e popullit. Në cilësinë e komisionit funksional ka shqyrtuar dhe amendamentuar tetë projektligje

- Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ka mbajtur 97 mbledhje dhe 7 dëgjime publike për projektligje që i përkasin sferës së shëndetësisë, ku njeri prej dëgjime publike është organizuar për tri p/ligje në të njëjtën kohë: P/ligjin për Punë, P/ligjin për Grevë dhe P/ligjin për të drejtat e organizimit sindikal. Komisioni për Shëndetësi ka mbikqyrur zbatimin e Ligjit për Shëndetësi dhe ka hartuar një raport të thukhtë prej të cilit kanë dalur një numër i konsiderueshëm rekomandimesh të cilat t'iu kanë adresuar spektrit të gjere shëndetësor si mjet për daljen nga kriza.

Komisioni për Punë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka shqyrtuar 22 P/ligje prej të cilave 12 janë miratuar në seance plenare nga Kuvendi i Kosovës kurse në procedurë shqyrtuese kanë mbetur gjithsej 10 P/ligje

- Komisioni për Arsim, Rini, Shkencë, Kulture dhe Teknologji gjatë këtij mandati ka mbajtur 99 mbledhje, ka organizuar 24 dëgjime publike që i përkasin kryesisht sferës së arsimit dhe ka bërë 7 vizita në terren
- Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor ka mbajtur 82 mbledhje, 10 takime në grupin e veçante për p/ligjet për dertimet ilegale dhe 19 vizita të ndryshme brenda Kosovës. Ky komision ka shqyrtuar 25 p/ligje, ku prej tyre 11 janë miratuar në seance plenare në Kuvendin e Kosovës, kurse në procedurë shqyrtuese janë edhe 14 p/ligje
- Komisioni për Bashkëpunim dhe Integritet Euroatlantike gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 24 mbledhje
- Komisioni për Siguri është formuar në muajin shtator 2006. Gjatë kësaj periudhe kohore ka mbajtur 18 mbledhje, ka shqyrtuar 5 p/ligje dhe ka organizuar 8 dëgjime publike. Asnjë prej ligjeve të shqyrtuara nga komisioni nuk janë shpallur nga PSSP-ja sepse këto ligje kryesisht rregullojnë çështje që ende vazhdojnë të mbesin kompetence e rezervuar



# I. Raport mbi Punën e Kuvendit të Kosovës për mandatin 2004-2007

- Komisioni për Ekonomi, Tegeti, Industri, Transport, Telekomunikacion, Miniera dhe Minerale ka mbajtur 113 mbledhje, ka organizuar 15 dëgjime publike, ka shqyrtuar 30 p/ligje, prej te cilave 5 nuk janë shpallur nga PSSP-ja. Ky komision ka iniciuar dhe hartuar dy p/ligje: P/ligjin për shpronësim me interes publik dhe P/ligjin për procedurën e dhënies së koncesioneve. Komisioni ka monitoruar edhe implementimin e dy ligjeve: Ligjin për transportin e mallrave të rrezikshme dhe Ligjin për mbrojtjen e konsumatorit


- Komisioni për Shërbime Publike, Administrate Lokale dhe Media ka mbajtur 67 mbledhje të rregullta dhe 9 dëgjime publike. Ky komision gjatë kësaj periudhe ka shqyrtuar dhe amendamentuar 13 projektligje.

Në kuadër të fushave të mbuluara nga Kuvendi i Kosovës në aktivitetin e tij legjislativ, KDI nxjerr një konstatim të përafërt të mbulimit të tyre, bazuar në nxjerrjen e ligjeve si dhe nismave tjera. Fushat më të mbuluara janë ato të shëndetësisë, planifikimi mjedisor, ekonomi dhe financa, tregti dhe industri, drejtësi, shërbime publike, të pasuara nga mirëqenia, arsimit, siguria, bujqësi.



## \*Shpjegim

Duhet nënvizuar se ky Raport është përpiluar në bazë të informacioneve të ofruara nga monitoruesit e KDI-së, dokumenteve publike të cilat disponon Kuvendi i Kosovës si dhe ato të dala nga bashkëpunimi i afërt me zyrtar të komisioneve të Kuvendit të Kosovës. Gjithashtu, një vështirësi e theksuar është vënë re si pasojë e organizimit administrativ jo-adekuat të Kuvendit në përpilimin, përcjelljen dhe shpjegimin e aktiviteteve të Kuvendit në mënyrë të strukturuar, faktike, dhe të shpejtë. Pavarësisht, gjatë kësaj periudhe tre-vjeçare vihen re një ndryshim dhe avancim në kulturën e përgjithshme të punës së administratës së Kuvendit në veçanti apo përgjithësisht.



Numri i nismave legislative nga ana e Komisioneve



## INTRODUCTION

Kosova Democratic Institute since February 2006 is engaged in proactive monitoring of the work of the Kosova Assembly and several Municipal Assemblies.

In monitoring of the work of Kosova Assembly for the three-year period, through this report KDI aims to give its contribution in offering structured information which will be in use, first of by Kosova citizens, civil society, media and by the monitored institution itself, the Kosova Assembly. In this direction, in classified way through this report, we offer data that reflects three aspects of the Assembly work.





KDI through proactive monitoring, but as well as in co-operation with the Assembly institution as a party involved in this process, has achieved to provide information, which could be further developed, in case of more specified cooperation by institution's side, or even in the case of their more authentic organization and functionality. Through monitoring activities KDI was engaged in directions such as the work of plenary sessions, Parliamentary Committees, interpellations and the lawmaking processes. During the three-year mandate, the Kosova Assembly has proceeded with draft laws, laws, amendments, resolutions, declarations, decisions and conclusions.

KDI would like to thank all its partners, elected officials and the Assembly staff for the contribution in providing data that enabled drafting of this report.

**Ismet Kryeziu**  
Executive Director



## OUR PUBLICATIONS





# Report on the work of Kosova Parliament during the mandate 2004-2007

## ROLE OF THE ASSEMBLY

**K**osova Assembly develops its work through plenary sessions and parliamentary committees.

Kosova Assembly undertakes activities through respective bodies such: Presidency of the Assembly, Parliamentary Groups, Parliamentary Committees and individual deputies. Based on "General Provisions" that defines the organization and functioning of the Kosova Assembly in general, as well as all specific bodies that Assembly establishes based on "Rule of Procedures of the Assembly of Kosova", as a result of this organization and functioning of the Assembly, can be determined in promulgation of:

- Amendments
- Declarations
- Draft laws
- Laws
- Motions
- Resolutions



**B**y its nature, these documents are divided into documents with obligatory law force for the Assembly and third parties, as well as on not-obligatory documents. Worth to mention is that the most important and primary mission for each represented institution is lawmaking through which is arranged the establishment, maintenance and functionality of other institutions as well as arrangement of specific social fields with which are associated with institutions. Kosova Assembly also aims at democratic lawmaking as well as improving Kosova citizen's welfare.

**I**n principle, based on the aforementioned documents, the Assembly approaches to a work which is summarized by an initiation for declaration, draft law, resolution or other document. As a second step, the Assembly through its plenary sessions, as well as through its Committees discusses and further re-discusses in detail a given initiative. Finally, the Assembly decides for a final shape of an initiative by making it officially legal or in the other case by rejecting it.

## NUMBER OF DRAFT-LAWS, RESOLUTIONS, DECLARATIONS, DECISIONS AND CONCLUSIONS


**K**osova government during its legislation in the 2004-2007 has proceeded to the Kosova Assembly 151 draft laws, whilst the Assembly on its own initiative has proceed 6 other draft laws from the total number of 157 draft laws. As a result, the Assembly declared and adopted 95 laws in total. Out of these draft laws 31 are in the reviewing process whilst 31 others were sent back to the Government for re-drafting.

**K**osova Assembly during three year mandate has initiated six legislative initiatives – (draft laws):

- Draft law on expropriation
- D/Law on Amendments and Additions to Law 2003/7 on Archive Material and Archives
- D/Law on procedure for giving concessions
- D/Law on Amendments and Additions to Law 2003/7 on Archive Material and Archives
- D/Law on the rights and responsibilities of the deputy
- D/Law on parliamentary investigation
- Whereas Deputy Fehmi Vula has presented an initiative for D/Law on Red Cross of Kosova

# Report on the work of Kosova Parliament during the mandate 2004-2007


According to the Kosova Constitutional Framework, laws that are adopted by the Assembly are proceeded for promulgation, suspension or denial by the Special Representative of the Secretary-General, SRSG. Therefore, SRSG upon the volume of the laws that were sent by the Assembly has promulgated 74 laws, while 32 remain un-promulgated.



**Draft laws that are not drafted in accordance to the norms and required standards, and without excluding budgetary implications as well, caused 31 draft laws to be returned for revision to Kosova Government.**

In the plenary sessions of the Kosova Assembly during the mandate 2004-2007 have been adopted 5 Resolutions, 3 Declarations, 88 Decisions and 16 Conclusions. Within adopted resolutions and declarations of the Kosova Assembly are: Resolution against crime in the field of cybernetics, Resolution on re-confirmation of politic will of Kosova people for Kosova as independent and sovereign state, Declaration of the Kosova Assembly for the Kosova riots, 21 September 2006, Declaration of the Kosova Assembly for the Serbian Constitution and Declaration of the Kosova Assembly for approving the Resolution of the European Assembly.

## Number of Resolutions, Declarations, Decisions and Conclusions



## UN-PROMULGATED LAWS BY THE SRSG ARE:

- Law on Freedom of Association of NGO-s
- Law on Goods General Safety
- Law on Central Heating
- Law on Status and Rights of Martyrs Families, Veterans and KLA Participants and Families of Civil Victims of the War.
- Law on Administrative Conflicts
- Law on Termination of Pregnancy
- Law on Geological Research
- Law on Traffic Safety
- Law on Health Insurance
- Law on Public Health
- Law on Protection from Noisiness
- Law on Apiculture
- Law on Blood Transfusion, Blood and its Products Control.
- Law on Personal Number
- Law on Personal Name
- Law on Chemicals
- Law on Prevention and Fighting of Contagious Diseases
- Law on fulfilment and modification of Law 2003/4 Liquidation and Reorganisation of Legal Persons
- Law on modification and fulfilment of Law 2003/14 on Spatial Planning
- Law on Treatment of Illegal Construction
- Law on Identity-card
- Law on modification and fulfilment of Law 2004/1 on Road Transport
- Law on Organic Agriculture
- Law on modification and fulfilment of Law 2004/46 on Civil Status Registers
- Law on Civil Status
- Law on Trade Societies
- Law on Dwelling-place and Emplacement
- Law on fulfilment and modification of Law 2003/25 on Cadastre
- Law on Arbitral
- Law on Herb Variety Protection
- Law on Financial Report of Enterprises
- Law on Expropriation

# Report on the work of Kosova Parliament during the mandate 2004-2007



**MOST OF THE DEBATES THAT WERE PRESENTED AND DISCUSSED DURING PLENARY SESSIONS OF THE KOSOVA ASSEMBLY WERE OF POLITICAL NATURE, AND WERE CHARACTERIZED MAINLY BY THE ONGOING PROCESSES OF DISCUSSIONS FOR THE KOSOVA STATUS AND THE POSSIBILITIES OF FINDING ITS SETTLEMENT, AND WERE FOLLOWED BY DEBATES IN SOCIAL, ECONOMIC AND SECURITY FIELD.**




## PLENARY SESSIONS AND DISCUSSED ISSUES

During the mandate 2004-2007, the Kosova Assembly held 63 plenary sessions in total and over 700 meetings of the Parliamentary Committees. In these plenary sessions important issues and the issues of public interest that were discussed such as:

- Debate on the Protocol-Administration Center – QAP “Germia”,
- Debate on bad situation at the University of Prishtina,
- Debate on energetic situation in Kosova,
- Debate on security situation,
- Debate on pensioners situation,
- Debate on sorely health situation,
- Debate on the missing persons,
- Debate on Education and Youth
- Debate on “Ahtisaar’s package”, as well as wider debates on the ongoing process of discussions for the Final settlement of the Kosova status in Vienna.

During the year 2005 the Assembly held 11 plenary sessions, in year 2006 marked the greatest number of plenary sessions, in total 27, whilst in 2007 25 plenary sessions were held. Also, the Kosova Assembly has called 16 interpellations or request for accountability by the executive.



**Number of Plenary sessions during years**

# Report on the work of Kosova Parliament during the mandate 2004-2007

## REQUESTS ON INTERPELLATION

Parliamentary Groups, have initiated Interpellation procedures, a procedure that requires from the government to clarify engagement or non-engagement regarding a specific issue, legal or politic. Therefore, the Kosova Assembly respectively parliamentary groups have performed the following procedure:

### During the year 2005, 5 interpellations were called:


- Interpellation of the Prime Minister Rramush Haradinaj, upon the request of PDK parliamentary group
- Interpellation of the Minister Slavisha Petkoviq, upon the request of SLKM parliamentary group
- Interpellation of the Prime Minister Bajram Kosumi, upon the request of PDK parliamentary group
- Interpellation of the Prime Minister Bajram Kosumi, upon the request of PDK parliamentary group
- Interpellation of the Minister Melihate Termkolli, upon the request of PDK parliamentary group

### During the year 2006, 5 interpellations were called:

- Interpellation of the Minister Melihate Termkolli, upon the request of PDK parliamentary group
- Interpellation of the Minister Qemajl Ahmeti, upon the request of PDK parliamentary group
- Interpellation of the Minister Adrian Gjini, upon the request of the deputy Naser Osmani, supported also by 10 deputies from the LDK parliamentary group
- Interpellation of the Prime Minister Agim Ceku, upon the request of PDK parliamentary group
- Interpellation of the Minister Sadik Idriz, upon the request of ORA parliamentary group

### During the year 2007, 6 interpellations were called:


- Interpellation of the Minister Haki Shatri, upon the request of ORA parliamentary group
- Interpellation of the Prime Minister Agim Ceku, upon the request of ORA parliamentary group
- Interpellation of the Prime Minister Agim Ceku, upon the request of ORA parliamentary group
- Interpellation of the Minister Ethem Ceku, upon the request of PDK parliamentary group
- Interpellation of the Minister Agim Veliu, upon the request of ORA parliamentary group
- Interpellation of the Minister Agim Veliu, upon the request of Integration parliamentary group



Requests on Interpellation during the years

## PARLIAMENTARY QUESTIONS

Through parliamentary questions, each member of the Assembly can submit questions to government member and request accountability or clarifications regarding a specific issue. During the period 2004-2007 in the plenary sessions of the Kosova Assembly 196 parliamentary questions were submitted. Most of the written questions that were submitted from the Assembly deputies were answered by the respective ministers to whom the questions were addressed, whilst 14 unanswered questions were published in the "Information Bulletin" of the Kosova Assembly.



Number of Parliamentary Questions



# Report on the work of Kosova Parliament during mandate 2004-2007

## MAIN AND FUNCTIONAL COMMITTEES

Parliamentary Committees presents essential pillars upon and the higher volume of the Assembly activities is based on, their division consists on main and functional committees. Depending from the needs, the Kosova Assembly may establish other Committees as well. Committees upon agreement with the Presidency of the Assembly may establish also supportive sub-committees.

During this mandate, the Assembly has established in total 10 parliamentary committees out of which 2 are Main and 8 are Functional Committees: Committee for Budget and Finance, Committee on Rights and Interests of the Communities; Committee for Health, Work and Social Welfare; Committee for Education, Youth, Science, Culture and Technology; Committee for Agriculture, Forestry and Rural development; Committee for Cooperation and Euro Atlantic Integration; Committee for Security; Committee for Economy, Trade, Industry, Transport, Mines and Minerals; Committee for Public Services, Local Administration and Media and Ad-hoc Committee that was established for the Rule of Procedures of the Assembly of Kosova. Committees of the Kosova Assembly during the mandate 2004-2007 have held over 700 meetings.

- Committee for Budget and Finance during the mandate 2004-2007 held 156 meetings, reviewed 148 draft laws, organized 5 public consultations and 7 budget hearings
- Committee on Rights and Interests of Communities held 102 meetings and reviewed 148 draft laws
- Committee for Legislation, Constitutional Framework, Gender Equality, Petitions held 80 meetings, 4 public hearings and drafted 3 legislative initiatives: Draft law on the rights and responsibilities of the deputies, Draft law on parliamentary investigation and Project Law on Ombudsperson. Functional committees have reviewed and amended 8 draft laws.

- Committee for Health, Work and Social Welfare has held 97 meetings and 7 public hearings for the draft laws belonging to health, where one of the public hearings was organized for three d/laws in the same time: D/Law on Work, D/Law on Strikes and D/Law on the rights of union organization. Committee for Health supervised Law on Health and has draft a detailed report out of which a considerable number of the recommendations came out that addressed a wide specter of the health as tools to overcome the crises. Committee for Health, Work and Social Welfare revised 22 D/Laws out of which 12 were approved in the plenary session of the Kosova Assembly whilst in the reviewing process 10 D/Laws remained

- Committee for Education, Youth, Science, Culture and Technology during this mandate held 99 meetings, organized 24 public hearings and conducted 7 field visits.
- Committee for Agriculture, Forestry and Rural development held 82 meetings, 10 meeting with a specific group for D/Law for illegal building and 19 different visits within Kosova. This Committee has reviewed 25 D/Laws, only 11 were approved at the plenary sessions of the Kosova Assembly. In the reviewing process are 14 D/Laws
- Committee for Cooperation and European Integration during this period held 24 meetings
- Committee for Security was established in September 2006. During this period it held 18 meetings, reviewed 5 D/Laws and organized 8 public hearings. None of the reviewed laws were promulgated by the SRSG because these laws mainly regulate issues that are still remaining as reserved competency.

## Report on the work of Kosova Parliament during mandate 2004-2007

- Committee for Economy, Trade, Industry, Transport, Telecommunication, Mines and Minerals held 113 meetings, organized 15 public hearings, reviewed 30 D/Laws and 5 were not promulgated by the SRSG. This Committee has initiated and drafted 2 D/Laws: D/Law on expropriation for public interest and D/Law on concessions procedures. Committee monitored the implementation of two laws: Law on transportation of the dangerous goods and Law on consumer protection.


- Committee for Public Services, Local Administration and Media held 67 regular meetings and 9 public hearings. During this period the Committee reviewed and made amendments to 13 draft laws.

Within the fields addressed by the Kosova Assembly in its legislative activities, KDI concludes an approximate coverage of the fields, based on adopted laws and other initiatives. Fields that are most covered are those belonging to health, environmental protection, economy and finance, trade and industry, justice, public services, followed by welfare, education, safety and agriculture.



### \* Note

We must envisage that this report was drafted based on given information from the KDI monitors, public documents that are available at the Kosova Assembly as well as information from the close cooperation with the officials of the Committees of the Kosova Assembly. Furthermore, an emphasized difficulty was seen as a result of non-adequate administrative organization of the Assembly in compiling, following and explaining the activities of the Assembly in more structured, practical and quick way. Despite, during this three-year period was seen a change and advancement in the general culture of the work of the administration of the Assembly either in particular or in general way.



Number of legislative initiatives by Committees



## Adresa e Kuvendit të Kosovës

Kuvendi i Kosovës  
Rr. Nënë Terezë  
10000 Prishtinë  
Kosovë

Web: [www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)  
Email: [info@assembly-kosova.org](mailto:info@assembly-kosova.org)

## Kuvendi i Kosovës

▪ Kuvendi i Kosovës përbëhet prej 120 deputetëve të zgjedhur me votën e lirë me sistem zgjedhor proporcional. Njëzet (20) ulëse janë të rezervuara për komunitetet joshqiptare.

Kuvendi është organi më i lartë **ligjvënës** dhe miraton ligje me të cilat qeveriset Kosova.

## Komisionet e Kuvendit të Kosovës

▪ Komisionet janë grupe të vogla të deputetëve të cilët mbulojnë një fushë të caktuar të çështjeve me të cilat merret Kuvendi.

Komisionet mundësojnë që Kuvendi njëkohësisht të kryej shumë funksione të rëndësishme: shqyrtimi në hollësi të projektligjeve të propozuara, raportimin në Kuvend mbi projektligjet e caktuara dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me mbikqyrjen e punës së Qeverisë.

Komisionet e Kuvendit të Kosovës janë:

1. Komisioni për Buxhet dhe Financa
2. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim
3. Komisioni për Çështjet Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, Barazi Gjinore, Peticione dhe Kërkesa Publike
4. Komisioni për Arsim, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sporte
5. Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor
6. Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media
7. Komisioni për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim në UE
8. Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
9. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
10. Komisioni për Siguri  
Komisioni *ad hoc* për Rregullore të Punës së Kuvendit të Kosovës  
Komisioni *ad hoc* për Media

## EKIPI YNË - OUR STAFF



**Ismet KRYEZIU**  
*executive director*



**Arsim GJINOVCI**  
*admin & finance*



**Fatmir HAXHOLLI**  
*project manager*



**Fitore ZENELI**  
*project coordinator*



**Nora VESELI**  
*project coordinator*



**Bleranda ZOGAJ**  
*project coordinator*



**Vjollca VOGËL**  
*project assistant*



**Sanije JAHIRI**  
*project coordinator*



**Edita MUSTAFA**  
*professional consultant*



**Violeta Zeka**  
*professional consultant*

### Adresa - Address

**KDI - Kosova Democratic Institute**

Rruga "UÇK" p.n, Prishtinë

Tel: (office) +381 38 248 988

email: [office@kdi-kosova.org](mailto:office@kdi-kosova.org)

web: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Përkrahur nga - Supported by:



**National Endowment  
for Democracy**

*Supporting freedom around the world*

---

This document has been financed by National Endowment for Democracy, NED. NED does not necessarily share the views expressed in this material. Responsibility for its contents rests entirely with the author.